



AKT KONSTRUKTIV

SHOQERISE (SH.R.S.F.)

“RES - 03” shpk

Ne baze te ligjit “Per shoqerite Tregtare” 7638 date 19.11.1992, ligjit 7667 date 28.01.1993 “Per regjistrimin tregetar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te dhe Ligjit NR. 8770 date 19.4.2001, formohet Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “**RES - 03” shpk**, me ortak te vetem themelues **MEJTIM MARKEÇI** i biri i Tahirit, lindur ne Diber, me 01.05.1966, banues ne Bulqize.

NENI 1

Ne kuptim te ketij Akti themelues eshte **MEJTIM MARKEÇI** Ortaku i Vetem dhe themelues i Shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar “**RES - 03” shpk**

NENI 2

Drejtuues teknik i shoqerise “**RES - 03” shpk** eshte **Z.SHEMSI ÇEKIÇI** i cili ka te drejtat dhe detyrimet qe percakton Ligji NR.8770 date 19.04.2001 dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi.

NENI 3

Qellimi i ketij Akti Themelimi eshte krijimi i shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar “**RES - 03” shpk** me Seli ne Bulqize dhe me perspektive shtrirje me gjithë territorin e Republikes.

NENI 4

Shoqeria “**RES - 03” shpk** eshte person juridik dhe veprimtaria e saj zhvillohet sipas statutit dhe Ligjit NR. 8770 date 19.04.2001 “Per Sheribimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike” dhe akteve te tjera te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.



-2-

KOHEZGJATJA

NENI 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "RES - 03" shpk eshte per nje periudhe 10 vjecare me te drejte perseritje.

OBJEKTI

NENI 6

Sipas ligjit NR. 8770 date 19.04.2001 Objekti i veprimtarise se shoqerise "RES - 03" shpk i paisur me licence e kategorise "a + b"

- a. Sigurimin e objekteve publike dhe private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise (Marrja e licences te Kategorise ("a").
- b - Sigurimin e mbrojtjes se jetes e te shendetit te personave fizike shtetas shqiptar e te huaj (Marrja e licences te Kategorise ("b").

NENI 7

Shoqeria "RES - 03" shpk do te filloje aktivitetin e saj nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane si dhe paisjen me lejen e ushtrimit te profesjonit nga Zyra e Tatimeve te Rajonit perkates.

KAPITALLI I SHOQERISE

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise "RES - 03" shpk eshte 4.000.000 leke, (kater milion) leke.

Ortaku i Vetem **Z. MEJTIM MARKEÇI** i cili disponon kete shume baraz me 100% e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tij.



BILANCI VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET

NENI 9

Shoqeria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore etj.

NENI 10

Ortaku i Vetem themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë që me nxjerrjen e bilanceve ekonomike të eperfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

JURIDIKSIONI

NENI 11

Shoqeria "RES - 03" shpk ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 12

Te gjitha mosmarrëveshjet me persona fizike apo juridike vendaj ose të huaj si dhe organet shtetërore zgjidhen nga Gjykata e Tiranës.

THEMELUESI

MEJTIM MARKEÇI


Mejtim Markeçi

STATUT

I SHOQERISE (SH.R.S.F.)

“RES - 03”shpk

FORMIMI



Sot, me date 13.11.2003 (dy mijë e tre) MEJTIM MARKECI i biri i Tahirit, lindur ne Diber, me 01.05.1966, banues ne Bulqize, i cili ka vendosur te krijojë Shoqerine private per Ruajtjen dhe Sigurine Fizike ne mbeshtetje te Ligjit NR. 8770 date 19.04.2001 “Per Shoqerine e Sigurimit e Ruajtjes Fizike“ (SH.R.P.) dhe Udhezimet e Ministrit te Rendit Publik NR. 1487.1488, 1489, 1490, 1491 e 1492 date 21.06.2001.

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij statuti qe do te beje dhe aktin baze te te rregullimit, sturkture e organizimit.

KTREU I

EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

NENI 1

Krijohet shoqeria e Rajtjes dhe Sigurise Fizike ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e qe shkurt do te quhet shoqeria **“RES - 03 ” shpk**

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte ne Bulqize.

Ajo gezon te drejten per te hapur filiale,dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu edhe jashte vendit.

NENI 3

Sipas ligjit NR. 8770 date 19.04.2001 Objekti i veprimtarise se shoqerise **“RES - 03” shpk** i paisur me licence e kategorise ” a + b

- a. Sigurimin e objekteve publike dhe private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise (Marrja e licences te Kategorise (“a “).
- b - Sigurimin e mbrojtjes se jetes e te shendetit te personave fizike shtetas shqiptar e te huaj (Marrja e licences te Kategorise (“b”).



NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është 10 vjet me të drejtë ripërtëritje. Nuk përjashtohet mundësia që për arsye të përligjura dhe të justifikuara shoqëria të pushojë aktivitetin e saj dhe [para afatit 10 vjeçar, duke njoftuar për këtë qëllim Organet Ministrisë së Rendit Publik që kanë leshuar licencën - Lejen për aktivitetin e mesipër].

NENI 5

Vendndodhja ligjore e personave të kontraktuar nga shoqëria dhe të paisur me lejen përkatëse nga organet e rendit në raport me shoqërinë është ajo që rezulton nga libri (lista) e anëtarëve të miratuar nga Organet e Rendit Publik të Rrethit e ato qendror.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali themelor i shoqërisë "**RES - 03**" shpk i investuar totalisht nga Ortaku i Vetëm **MEJTIM MARKEÇI** është 4.000.000 (kater milion) leke për aktivitetin e shoqërisë në bazë të ligjit NR. 8770 datë 19.04.2001

NENI 7

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë ortaku i Vetëm.

NENI 8

Me miratimin e Ortakut të Vetëm nuk përjashtohet mundësia e hyrjes së Ortakut në Shoqëri duke transferuar kuotat sipas marrëveshjes së arritur midis atij dhe Administratorit të Shoqërisë.

KREU III

NENI 9

Shoqeria "RES - 03" shpk eshte prone e Ortakut te vetem te saj i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise;

Administrator i shoqerise eshte Ortaku i vetem **MEJTIM MARKEÇI** i cili ka kopetenca te vendose per gjitheshka qe lidhet me aktivitetin, organizimin, ndarjen e punes, caktimin e detyrave te pergjitheshme e te vecanta , kontrollin per zbatim e tyre dhe marrjen e masave perkatese per mospermbushtjen e rregullt nga cilido punonjes.

Per drejtimin teknik shoqeria sipas ligjit NR. 8770 date 19.04.2001 eshte **Z. SHEMSI ÇEKIÇI** i cili ka detyrat dhe te drejtat qe percaktohen ne kete ligj.

NENI 10


Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise Ortaku i Vetem emerion e puneson Administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre.

Administratori e emruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shjperhimisht Ortakut te vetem.

KREU IV
ADMINISTRIMI

NENI 11

Administrimi i Shoqerise "RES - 03" shpk i perket Ortakut te vetem .
Me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise nuk perjashtohet mundesia qe detyren e Administratorit ta kryej edhe nje person tjeter kundrejt te drejtave qe do t'i besohen nga ortaku.





NENI 12

Punesimi i personave ne shoqeri qe duan te pranojne te kryejne aktivitetin e sherbimit te ruajtjes dhe sigurimit fizik behet kundrejt kontrates se lidhur midis secilit dhe Administratorit te Vetem te shoqerise.

Me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise mund te pajtohen ne pune edhe persona te tjere qe do te jene ne ndihme dhe funksion te sherbimit te ruajtjes.

Drejtuesi Teknik ben pergatitjen e punonjesve qe kerkojne te punesohen ne shoqeri dhe ploteson detyrimet ne baze te Ligjit per paisjen me licence te ushtrimit te profesjonit si punonjes sherbimi, ben pergatitjen dhe kualifikimin Teoriko-Praktik te personelit ne perputhje me teknikat bashkekohore dhe dispozitat ne fuqi.

KREU V

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 13

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti,pervec rasteve dhe urdherave te vecanta te Ortakut te Vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik *humbje, fitime*. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe mbas pagimit te detyrimeve fiskale. Pjesa qe mbetet i jepet per perdorim ortakut te vetem te saj.

NENI 14

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie. Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues mbasi te jene shlyer te gjitha detyrimet tatimore, detyrimet ndaj te treteve si dhe pagesat e mundshme per punonjsit e shoqerise.



SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 15

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak. Ne rast mbyllje, ortaku i fvetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore duke i percaktuar edhe detyrat konkrete. Ne rastin e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitet e duhura, shoqeria c' rregjistrohet ngas rregjistri tregetar i asaj gjykate.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 16

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga Administratori i saj **Z.MEJTIM MARKECI**.

Statuti perpilohet ne kater kopje per t'ju shperndare organeve kompetente per rregjistrin e saj si person juridik dhe si Subjekt Privat. Nje kopje e tij do te mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise

Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"RES - 03" shpk**

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
MEJTIM MARKECI

Mejtimo Markeci